

NATURAL KALK



PËRSHKRIMI

Është material në formë pluhuri i prodhuar në bazë të teknologjisë HTT (Horman Transpirance Tecnology). Parandalon krijimin e mykut dhe lejon transpirimin e murit më bazë çimento, gelqere e hidratuar, rërë guri karbonik dhe mermer me granulometri të seleksionuar, rezina sintetike dhe aditive special.

KARAKTERISTIKAT E PRODUKTIT

- Karakterizohet nga hapje dhe punueshmëri mjaft e mirë
- Lehtëson aplikimin në sipërfaqe të jashtme edhe të brenshme të mbushura si me llaç tradicional ashtu dhe me llaç të parapërgatitur.
- E aplikueshme deri në një trashësi deri në 3 mm

PËRDORIME TË REKOMANDUARA

I përshtashëm për realizimin e rifiniturave të sipërfaqeve të mbushura me llaç tradicional ose me llaç të parapërgatitur me bazë çimento-gëlqere. Mund të mbulohet me bojë, ose me veshje të tjera me natyrë minerale dhe sintetike. Nuk duhet të shtohen komponent të tjerë si çimento, gëlqere, etj në produktin e dhënë. Nuk duhet të aplikohet mbi sipërfaqe të lyera më parë, sipërfaqe apo mbi veshje plastike, sipërfaqe me trashësi me të madhe se 3 mm, në vende ku ka veshje prej qeramike, sipërfaqe me bazë gipsi, sipërfaqe lehtësisht të thyeshme apo të shkatërruara. Nuk duhet të shtohet uji mbasi përbërja është përgatitur. Duhet të aplikohet në temperatura nga +5°C deri +35°C.

KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Rezina	Pluhur
Ngjyra	Gri/Bardhe
Raporti i Përzierjes	7. 5-8litra ujë për 25kg Natural Kalk të bardhë /gri
Temperatura e aplikimit	Nga +5°C deri +35°C
Trashësia për dorë	3mm
Koha e pritjes për aplikimin e dorës së dytë	30-40 min
Koha e pritjes deri në fërkim	15-20 min
Koha e pritjes për lyerjen e sipërfaqes	3-4 javë
Djegshmëria	I padjegshëm
Rezistenca në shtypje mbas 28 ditëve	≥ 3Nmm ²
Rezistenca në përkulje mbas 28 ditëve	≥1.3 Nmm ²

PËRGATITJA E SIPërFAQES

Sipërfaqja apo suporti ku do të vendoset NATURAL KALK duhet të jetë i niveluar dhe i qëndrueshëm. Sipërfaqet me disnivel më të madh se 3 mm duhet të nivelohen përpara aplikimit të produktit.

MËNYRA E PËRGATITJES SË PËRZIERJES

Në një enë hidhni 7.5-8 litra ujë dhe 25 kg Natural Kalk. Përzieri me një përzierës elektrik me numër të vogël rrotullimesh derisa masa të bëhet homogjene. Për të stimuluar karakteristikat e përzierjes dhe për të pasur një rezultat sa më të mirë rekomandohet që përzierja të lihet në qetësi rreth 10 minuta dhe të trazohet përsëri përpara përdorimit.

MËNYRA E APLIKIMIT TË PRODUKTIT

Materiali duhet të përhapet me një mallë metalike duke siguruar një shtresë uniforme në të gjithë sipërfaqen. Dora e dytë e materialit duhet të aplikohet 30 minuta mbas aplikimit të dorës së parë. Pasi arrihet tharja e duhur rreth 15 minuta në temperaturë 23°C sipërfaqja duhet fërkuar me përdaf. Temperatura e ambientit ndikon ndjeshëm në kohën e punueshmërisë së produktit. Sa më e ulët të jetë temperatura aq me shumë zgjatet koha e punueshmërisë.

RUAJTJA

12 muaj nëse ruhet në një vend të thatë, larg burimeve të nxehtësisë, në një temperaturë midis +5°C dhe +30°C. Mbrojeni nga ngrica.

INFORMACIONI MBI SHËNDETIN, SIGURINË DHE MJEDISIN

Mbajeni larg fëmijëve produktin. Nëqoftëse gëlltitet lajmëroni dhe kërkoni ndihmën e mjekut dhe tregojini atij përmbajtjen e ambalazhit. Mos e hidhni produktin në tubacione ose kanale.

